

**A K T**  
**T H E M E L I M I**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“exsolvo” Sh.p.k.**

Me anë të këtij dokumenti, të emërtuar Akt-Themelimi, sot, më 30/03/2023, **Ardit Spahiu, nënshtetas shqiptar, Datëlindje 04/04/1990, me Nr.ID J00404104K**, bie dakort për sa më poshtë vijon:

Themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar : **“exsolvo” Sh.p.k.**

- (1) Selia e shoqërisë caktohet në Durrës, L.3, Rruga Ramazan Jella 00690691, Pallati Teuta Konstruksion Nr.67, Kati i parë, Z.K. 8514.

Emërtimi tregtar i shoqërisë është : **“XOLVO Solutions”**.

Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një afat kohor të pakufizuar.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: Shoqëria ka për objekt aktiviteti:

Këshillim biznese, individë, startup, shqiptarë ose të huaja, duke përfshirë por pa u kufizuar në këshillim fiskal, strategjik, ligjor, manaxherial, transformimi dixhital, operacional. Shoqëria do të marrë përsipër këshillimin në lidhje me burimet njerëzore, Kodin e Punës RSH, negocium, këshillim dhe përfaqësim për të përmbushur procedurat e rekrutimit të punonjësve shqiptarë ose të huaj. Ndërmjetësim në tregun e punës. Këshillim dhe shërbime për procedurat elektronike. Mbatje e librave të llogarisë, konsulencë me ligjin "Për Shoqëritë Tregtare". Konsulencë për Procedurat Tatimore.

**Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 [njëqind mijë] lekë.**

Ky kapital përbëhet nga kontributi i mëposhtëm në para i Ortakut të vetëm:

<b>Ardit Spahiu</b> disponon 1 pjese te kapitalit (100% te kapitali) 100.000 Leke
---

Shuma e nënshkruar do të depozitohet në Bankë në afatin dhe kushtet që përcaktohen për këtë qëllim me vendim të zakonshëm të shoqërisë.

Administratori emërohet me afat 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje.

Administrator i vetëm caktohet **Ardit Spahiu**.

Administratori gëzon kompetencat dhe i ushtron ato në përputhje me ligjin dhe statutin e shoqërisë. Shoqëria ka një Administrator të vetem. Me vendim të Ortakëve mund të shtohet numri i Administratoreve.

Asambleja e Ortakëve, shqyrton dhe vendos mbi llogaritë e vitit financiar, miratimi bëhet automatikisht, sipas modalitetit të vendimarrjes, kalimin e këtyre akteve dhe angazhimeve në ngarkim të Shoqërisë .Viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Ky Akt Themelimi është hartuar në Durrës në tre ekzemplare origjinal duke pasur të gjithë ekzemplarët fuqi të barabartë ligjore.

FIRMOSUR NGA ORTAKU

**ARDIT SPAHIU**

